



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1232/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nehat Tërpeza - Kandidat për Asamble Komunale (LDK) dega në Lipjan, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV) dega në Lipjan, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Nehat Tërpeza - Kandidat për Asamble Komunale (LDK) dega në Lipjan.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:47 nga parashtruesi i ankesës Nehat Tërpeza - Kandidat për Asamble Komunale ku pretendohet se, në QV 1304E, 1324E1317E, 1330C, nuk më figuron asnjë votë, ku më tutje ka shtuar se në këto QV i kamë përcjellur disa prej familjarëve të mi për të votuar, pra unë radhitem me 29 vota, mirëpo nga rezultatet e KKZ-së në katër QV unë nuk kam asnjë votë, për qka jam i bindur se kam pasur vota të mjaftueshme. Parshtruesi i ankesës i ka bashkangjitur disa fletlista të formularëve informativ.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga Nehat Tërpeza - Kandidat për Asamble Komunale (LDK) dega në Lipjan pretendohet se në, vendvotimet 1304E, 1324E1317E, 1330 jamë dëmtuar, mirëpo një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1232/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit**

**Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.